



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA /VLADA-GOVERNMENT
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
Ministarstvo Rada / Socijalne Zaštite-Ministry of Labour and Social Welfare
Sektor i Arkivit-Sektor Archive-Archive Sector

Nr. Prot: _____
Braj Prot: 1957
Prot. No: _____
Data: 22, 10, 20
Date: _____/20____
Prishtinë-Prishtina-Prishtina

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE / MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE / MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE


KONTRATA

Titulli: Dezinfektimi I Objekteve të APRK ,ZP, QAP

Nr. i Prokurimit¹ 209-20-5183-2-3-6

Nr i brendshëm MPMS/209/20/015/236

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit



KONTRATA

MINISTRIA E PUNES DHE MIREQENIES SOCIALE, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

" Dezinfektimi Profesional " SH.P.K., Rr.Muharrem Fejza, 10000, Prishtinë (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Dezinfektimi I Objekteve të APRK ,ZP, QAP me numër Identifikues **209-20-5183-2-3-6**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë dezinfektimin e gjitha hapësirave brenda objektit të cilin e shfrytëzojnë APRK, ZP dhe QAP në hapësirë (17170 m²), numri i intervenimeve është 6 herë për gjashtë muaj.

Dezinfektimi i hapësirave brenda objekteve sipas listes se paraqitur me poshtë, përfshinë:

- a) zyrat punuese,
- b) sallat e trajnimeve,
- c) toaletet,
- d) korridoret,
- e) hapësirën brenda liftit,
- f) hapësirën e arkivës,
- g) depot,
- h) kabina e punëtorit të sigurimit fizik, dhe
- i) hapësirën brenda bufes.

Nr.rendor	Objektet e Agjencionit të Punësimit	Totali i (17170m ²)
1	QRP Prishtinë	800
2	ZKP Fushë Kosovë	70
3	ZKP Obiliq	308
4	ZKP Podujevë	300
5	ZKP Lipjan	153
6	ZKP Novobërdë	220
7	ZKP Drenas	190
8	Qendra e Aftësimeve Profesionale Prishtinë	890
9	ZKP Graçanicë	50

10	Qendra e Aftësimeve Profesionale Prizren	1200
11	QRP Prizren	660
12	ZKP Dragash/Sharr	380
13	ZKP Suharekë / Therandë	220
14	ZKP Rahovec	149
15	QRP Pejë	780
16	ZKP Istog/Burim	280
17	ZKP Klinë	196
18	Qendra e Aftësimeve Profesionale Pejë	753
19	QRP Gjakovë	582
20	ZKP Deçan	260
21	ZKP Malishevë	276
22	Qendra e Aftësimeve Profesional Gjakovë	980
23	QRP Gjilan	527
24	ZKP Viti	235
25	ZKP Kamenicë /Dardanë	251
26	Qendra e Aftësimeve Profesionale Gjilan	987
27	ZKP Partesh	153
28	ZKP Ranillug	220
29	QRP Ferizaj	1034
30	ZKP Kaçanik	73
31	ZKP Shtime	327

32	ZKP Shtërpce	18
33	Qendra e Aftësimeve Profesionale Ferizaj	834
34	Qendra e Aftësimeve Profesionale Mitrovicë	1049
35	QRP Mitrovicë	830
36	ZKP Skenderaj	340
37	ZKP Vushtri	250
38	ZKP Leposaviq	45

Në çmim duhet te përfshihen edhe shpenzimet e transportit

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 22.10.2020 dhe përfundon me 22.04.2021

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë: sipas specifikimit teknik të Aneks.1 në dosjen e tenderit dhe pika 1.1 e nenit të kontratës.

1.5 Incotermit i aplikueshëm do të jetë DDP² (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **[480.76€] €; [katërqind e tetëdhjetë euro e shtatëdhjetë e gjashtë cent] Euro.**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Kontrata përbëhet nga me shume se një dërgesë shëno

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data

² DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *shërbimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 7 muaj, pas pranimit të *shërbimeve*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *shërbimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykata ekonomike e Prishtinës në pajtim me ligjin e Kosovës.





Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, për menaxhim kontrate është z. Kadri Sahiti, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqip³ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	DURIM AHMETAJ	Emri:	Edi Tahiri
Pozita:	DREJTOR MENAXHUES	Pozita:	Kryesori i Divizionit Prokurim
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	22.10.2020	Data:	22.10.2020
Vula:		Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Nr. i Artikullit.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njesi DDP ¹ - €	Çmimi total €	Koha e dërgesës
1.	Dezinfektimi I Objekteve të APRK, ZP, QAP	m2	17170	0.028	480.76	Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.
Totali i Përgjithshëm:					480.76	

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISE	DEZINFEKTIMI PROFESIONAL SH.P.K
ADRESA E PLOTE	RR. MUHARREM FEJZA P.N, 10000 PRISHTINË
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI	DURIM AHMETAJ
POZITA	DREKTOR MENAXHERIAL
NENSHKRIMI	
DATA	21.09.2020
VULA	

¹ Detyrimi i Dorëzimit është Paguar - Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombetare.